



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 101, Datë 12.05.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HYDROPOWER” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE
FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1589/1 prot., datë 08.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj”,

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguroese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “HYDROPOWER” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 MW, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022, për një afat 25 vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589 prot., datë 23.04.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj, në favor të Raiffeisen Bank sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 5, gërma “j” dhe 6 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licensuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”**: Shoqërisë duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve.
- **gërma “e”**: Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.
- **gërma “h”**: Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e kredisë dhe kontratat e hipotekës, të lidhura me “Raiffeisen Bank” sh.a., për një financim në funksion të zhvillimit të projektit fotovoltai. Megjithatë, në marrëveshjet e paraqitura nuk përmbajnë një listë të detajuar të aseteve fikse (të paluajtshme) që kërkohet të transferohen, me vlerat përkatëse dhe vlerën totale të tyre. Në këto kushte, shoqëria duhet të depozitojë në ERE: listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre) e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e Kontratës së Hipotekës që i shërben veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në ERE.
- **gërma “j”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka patur transferime të aseteve të kryera më herët nga ana saj.
- **Pika 6**: Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t’i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga “Kontrata e Kredisë” nr. 5460 rep., nr. 1472 kol., datë 23.08.2023, lidhur ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. dhe shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “HYDROPOWER” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI